

20241833170

## QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për tregti (\*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/04, 128/06, 63/07, 88/08, 159/08, 20/09, 99/09, 105/09, 115/10, 158/10, 36/11, 53/11, 148/13, 164/13, 97/15, 129/15, 53/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 77/21, 215/21, 295/21 dhe 150/22), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 3 shtator të vitit 2024, miratoi

### VENDIM PËR KUSHTE TË VEÇANTA PËR TREGTI ME MALLRA TË CAKTUARA

#### Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet marzhi më i lartë tregtar (fitimi) si kusht i veçantë në tregtinë me pajisje shkollore, edhe atë:

- - Çanta shpine dhe çanta
- - Fletore, blloqe, fletore për shënime, kolazhe
- - Mjetet e shkrimit (lapsa dhe stilolapsa)
- - Ngjyra druri
- - Plastelinë, teste të modelimit, shtresat
- - Flomasterë dhe markerë
- - Ngjyra të yndyrshme
- - Ngjyra tempera, akrile, uji dhe brusha
- - Liniarë dhe materiale didaktike
- - Mprehës dhe goma për fshirje
- - Gërshërë për fëmijë
- - Këllëfe, etui dhe aksesore shkollore
- - Ngjitës
- - Gjashtëkëndësha, kalkulatorë, kompasë dhe thjerrëza zmadhuese
- - Gota për pajisje dhe mbajtëse
- - Letër dekorative
- - Dosjet dhe çantat e kartonit dhe
- - Materiale për përpunim

Marzhi më i lartë tregtar (fitimi) për mallrat nga paragrafi 1 i këtij neni për të gjitha shoqëritë dhe tregtarët e vetëm që marrin pjesë në zinxhirin tregtar me shumicë përcaktohet në vlerën e përgjithshme deri në 5%, dhe në tregtinë me pakicë përcaktohet në vlerën e përgjithshme deri në 10%.

#### Neni 2

Marzhi më i lartë tregtar (fitimi) i mallrave të përmendura në nenin 1 të këtij vendimi do të zbatohet deri më 20 tetor të vitit 2024.

#### Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr. 41-8212/3  
3 shtator të vitit 2024  
Shkup

Kryetar i Qeverisë  
i Republikës së Maqedonisë së Veriut,  
Prof. Dr. **Hristijan Mickoski**, s.r.